



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:141556

Datë: 28.02.2025

Numri i dokumentit: 06919926

PKR.nr.88/2007

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Xhemajl JUSUFI, anëtar të trupit gjykues, gjyqtarët Ali KUTLLOVCI dhe Marigona LAJQI, me zyrtaren ligjore Doruntina BEKA, në lëndën penale ndaj të pandehurit M.M., për shkak të veprave penale Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të Ligjit penal të Kosovës (*tutje si: LPK*), lidhur me nenin 19 të Ligjit Penal i Jugosllavisë (*tutje si: LPJ*) dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armës nga neni 328 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (*tutje si: KPPK*), duke vendosur sipas Aktakuzës së ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP.nr.96/05, të datës 19.03.2007, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 06.02.2025, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Sahit Tmava, i pandehuri M.M. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokat Rexhep Kaçaniku, me datë 07.02.2025 e shpalli publikisht, ndërsa me datë 28.02.2025 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.M., nga i ati L., i lindur me datë, në fshatin S., Komuna Vushtrri, tani me vendbanim në fshatin Vilanc, Komuna Vushtrri, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i katër fëmijëve, i pa punë, pensionit invalidor, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

LIROHET NGA AKUZA

Sepse nuk është vërtetuar se:

I. Me 24.10.2000, rreth orës 18:40 minuta në fshatin Maxhunaj, Komuna Vushtrrisë, në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit I.M. me dashje ka filluar të kryej veprën penale të vrasjes por nuk e ka përfunduar në atë mënyrë që, me vetëdije të plotë se mund ta privojë nga jeta fillimisht ka ardhë me traktor deri në vendngjarje i armatosur me pushkë ilegale automatike, ka zbrit në tokë e ka marrë në shënjestër viktimën me tytë automatiku dhe duke ia tërheqë këmbëzën ka shtënë 2-3 rafalë kah ai por viktimja menjëherë është shtrirë për tokë dhe për këtë ka dështuar ta qëllloi,

ndërkohë që kanë ndërhyrë edhe dëshmitarët S.M. me tre fëmijë dhe T.M., për çka vepra nuk ka përfunduar.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale: Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së.

Sa i përket pikës dy (II) të dispozitivit të aktakuzës, në mbështetje të nenit 362 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-së, për të pandehurin:

REFUZOHET AKUZA

II. Në datën, orën dhe vendin e njëjtë si në pikën I të dispozitivit, ka vringëlluar dhe përdorë armën me frikësim dhe kërcënim në atë mënyrë që, me armën e përmendur si në pikën I të dispozitivit së pari e ka reperitrat e pastaj disa herë ka shtënë rafalë me të dhe kështu ka shkaktuar ndjenja shqetësimi të thellë dhe të rrezikimit të të dëmtuarit N.M..

Me këtë kishte për të kryer veprën penale: Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armës nga neni 328 par.1 të KPPK-së.

-Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet e kësaj Gjykate.

- Sa i përket kërkesës pasurore juridike, i dëmtuari sipas pikës I të dispozitivit të aktakuzës I.M., ka ndërruar jetë.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës

Ish Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur Aktakuzën PP.nr.96/05, të datës 19.03.2007 ndaj të pandehurit M.M. për shkak të veprave penale Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armës nga neni 328 par.1 KPPK-së.

Bazuar në dispozitat procedurale të cilat ishin në fuqi në atë kohë, konfirmimi i aktakuzës ndaj të pandehurit ishte bërë me datë 16.05.2007, përmes Aktvendimit P.nr.88/07, nga ish gjyqtarja për konfirmim të aktakuzës, të asaj kohe, pas mbajtjes së seancës për konfirmimin e aktakuzës në të njëjtën datë, pra 16.05.2007.

Gjykata, lidhur me këtë çështje penale, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 06.02.2025, ashtu që në këtë seancë, prokurori i shtetit, para leximit të aktakuzës, është tërhequr nga ndjekja penale sa i përket pikës II të dispozitivit të aktakuzës, për arsye të parashkrimit së kësaj vepre, tutje në këtë seancë i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas pikës I të dispozitivit të aktakuzës. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, në cilësinë e dëshmitarëve, janë dëgjuar N.M., I.M., S.M. si dhe T.M., është bërë leximi i deklaratës së të

dëmtuarit I.M., si dhe dëshmitarit A.M., pasi që të dy kanë ndërruar jetë, ndërsa as në propozim të aktakuzës, e as në seancën e shqyrtimi kryesor nuk kishte të propozuar për administrim asnjë provë materiale, i akuzuari ka mbetur në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici dhe palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare të tij ka deklaruar: nga provat që gjenden në shkresat lëndës, e nga të cilat edhe është ngritur aktakuza, duke filluar nga dëshmitë e të dëmtuarve I. dhe N.M., dëshmime të dëshmitares S.M. provohet kryerja e veprës penale si në aktakuzë. Nga dëshmia e të dëmtuarit I.M. qartë ceken veprimet inkriminuese të të pandehurit, kur thekson se M. e ka gjuajtur disa herë rafal të shkurtër me automatik, që nënkupton se qëllimi i tij ka qenë privimi nga jeta të dëmtuarit. Tutje ka theksuar se edhe nga deklarata e N.M.t, gjithashtu janë cekur veprimet e të pandehurit, kur thekson se e ka kapur babain e të pandehurit I. mburojë, derisa është larguar së bashku me të, e në ato momente M. ja kishte drejtuar a.të dëmtuarit I. dhe ka shtënë 2-3 rafalë, në të cilat momente ka ndërhyrë S. dhe fëmijët, kurse T.ka shkuar te i dëmtuari I., ku gjithashtu edhe pas largimit ka pasur një rafal dhe rafalët kanë vazhduar disa herë, derisa kanë ardhur policia. Veprimet inkriminuese të të pandehurit provohen edhe nga deklarata e dëshmitares S.M.,e cila ka theksuar se i pandehuri ka shtënë në drejtim të bashkëshortit të saj I.M., mirëpo pasi që I. është shtrirë për tokë vepra shihet se ka mbetur në tentativë. Përfundimisht prokurori i shtetit ka theksuar se nga të lartcekurat qartë shihet dashja e të pandehurit, që të dëmtuarve t`iu shkaktoj lëndime, dashje kjo e cila provohet edhe nga këmbëngulësia e tij i cili disa herë ka shtënë në drejtim të të dëmtuarit, me qëllim të arritjes së qëllimit të filluar, andaj i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor, ta dënoj sipas ligjit duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara me ligj.

Mbrojtësi i të pandehurit M.M., avokat Rexhep Kaçaniku, fjalën përfundimtare të tij, ka deklaruar se: vepra penale e vrasjes, në rastin konkret e mbetur në tentativë, kryhet vetëm me dashje dhe atë direkte, e as në procedurën paraprake, e as në shqyrtim nuk është provuar dashja e të akzuarit, madje i pandehuri thekson se fare nuk ka marrë pjesë në këtë rast. Gjithashtu ka theksuar se në vendin e ngjarjes nuk është gjetur asnjë gëzhøjë, e as armë zjarri, po ashtu as në shtëpinë e të pandehurit policia nuk ka gjetur pushkë automatike. Tutje ka theksuar se dëshmitarja S. M. ishte shumë konfuzë dhe nuk mund të mbështetemi në deklarin e saj , ndërsa për deklaratën e N.M.t ka theksuar se i njëjti e përshkruar versionin e tij, sikur i pandehuri të kishte dashur ta vriste. Përfundimisht ka theksuar se nga shkresat e lëndës nuk u dëshmuua se aktakuza kundër të akzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që duke aplikuar parimi “in dubio pro reo” të pandehurin ta liroj nga akuza.

I pandehuri M.M., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështet fjalën e mbrojtësit dhe nuk ka çfarë të shtoj tjetër.

Provat e administruara

Gjykata rithekson se në aktakuzë, e gjithashtu as në seancën e shqyrtimit kryesor nuk kishte asnjë provë materiale të propozuar për tu administruar.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur me datë 06.02.2025, gjykata ka dëgjuar dëshmitarët N.M., I.M., S.M., si dhe T.M., ndërsa gjatë seancës, në kuptim të nenit 335 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, janë lexuar deklaratat e të dëmtuarit I.M., si dhe dëshmitarit A.M., pasi që, të dy këta kanë ndërruar jetë.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar N.M., i njëjti ka deklaruar se ditën kritike, kur ka ndodhur rasti ka qenë në arë, pasi që është kthyer nga puna e ka parë M. këtu të pandehurin me traktor duke lëvruar arën dhe i është afruar për ti thënë të mos e dëmtoj rrugën të cilën e përdor edhe dëshmitari për të dalë në asfalt dhe derisa i njëjti ka qenë duke u afruar te M., M. ka marrë automatikun dhe ka gjuajtur në drejtim të tij fillimisht, e pastaj në drejtim të I.M.t, e po ashtu i njëjti ka theksuar se në ato momente e ka pasur afër babain e M., I.M. të cilin e ka kapur dhe në një formë e ka përdorë si mburojë, derisa kanë shkuar T. dhe S.M. bashkë me fëmijët që ti ndajnë, ku të njëjtat sipas tij kanë qenë rreth 100 metra larg tyre. Tutje ka theksuar se të shtënat kanë qenë edhe një nga një edhe rafal, por se sa të shtëna kanë qenë nuk i kujtohet. Në deklaratën e tij po ashtu ka theksuar se nuk e din nëse M. ka shtënë apo jo në drejtim të tij, pasi që nuk ka dëgjuar asnjë predhë të ketë kaluar pranë tij, sipas tij ka mundur që të ketë shtënë vetëm në drejtim të I., por për këtë nuk ka qenë i sigurt. Sa i përket pozicionit përkatësisht drejtimin e armës, ka theksuar se i pandehuri armën e ka mbajtur me tytë pak me lart në momentin kush ka shtënë. Përfundimisht ka theksuar se kur e ka lëshuar I., M. ka pasur mundësi që të gjuajë , mirëpo nuk ka gjuajtur.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor është dëgjuar edhe dëshmitari I.M., babai i të pandehurit, i cili është njoftuar nga kryetari i trupi gjykues se duke marrë parasysh dënueshmërinë e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, në kuptim të nenit 124 të KPP-së , nuk është i liruar nga detyrimi për të dëshmuar, andaj i njëjti ndër të tjera ka deklaruar se, ka qenë prezent ditën kritike kur ka ndodhur rasti, përkatësisht ka qenë në arë duke punuar me M. dhe diku afër mbrëmjes ka shkuar N. dhe I.M., të cilët kanë qenë larg diku rreth 50-60 metra, sipas dëshmitarit të njëjtit as nuk janë afruar, e as nuk ka biseduar me ta, e më pastaj kanë ardhur edhe disa gra dhe i kanë tërhequr në shtëpitë e tyre. Tutje ka theksuar se I.M. ka pasur me vete një kallash në dorë dhe ka shtënë katër-pesë rafalë në drejtimin tonë, në ato momente M. ishte ndalur duke rregulluar traktorin, dhe përfundimisht ka theksuar se N. nuk e ka kapur në mënyrë që të fshihej pas tij.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor në cilësi të dëshmitares është dëgjuar S.M., e cila ka deklaruar se ditën kritike, fëmijët e familjes M.dhe ata të familjes së tyre kanë dalur për të luajtur dhe janë kacafytur në mes vete, pastaj N. dhe I.kanë dalë jashtë që të shikojnë se çfarë ka ndodhur, pastaj ka shkuar i pandehuri me automat dhe ka filluar që të gjuajë, derisa dëshmitarja ka hyrë ndërmjet M. , I. dhe N., e gjithë kjo ka ndodhur në arë, afër shtëpive të tyre, mirëpo që sipas dëshmitares tri ditë më vonë pas ngjarjes familjet janë pajtuar në mes vete. Tutje ka deklaruar se i pandehuri ka shtënë në drejtim të bashkëshortit të saj, I.M.t, të cilët kanë qenë në distancë afërsisht rreth 25-30 metra, i pandehuri ka shtënë vetëm një herë sipas dëshmitares, dhe se i pandehuri në ato momente ka qenë në rimorkio të traktorit, ndërsa ka theksuar se bashkëshorti i saj nuk ka pasur

armë me vete atë ditë, dhe se nuk i kujtohet nëse N. ka qenë afër babait të pandehurit në ndonjë moment.

Po në këtë seancë të shqyrtimi gjyqësor është dëgjuar edhe dëshmitarja T.M., e cila ndër të tjera ka deklaruar se ditën kritike ka qenë duke përgatitë darkën dhe në ato momente i ka dëgjuar fëmijët duke qarë, pastaj ka dalë për të shikuar se çfarë ka ndodhur dhe aty në rrugë afër shtëpisë i ka parë N., fëmijët, si dhe S.M., pastaj i ka marrë fëmijët për ti futur brenda. Tutje ka theksuar se vetëm ka dëgjuar që ka ndodhur një zënkë e vogël, mirëpo se nuk e di as çfarë zënke ka qenë, as nuk i kujtohet se a ka dëgjuar ndonjë krismë atë ditë, vetëm e dinë se janë mbledhur burrat dhe kushërinjtë që ta zgjidhin atë çështje.

Siç u theksua më lart, në pamundësi të prezencës së të dëmtuarit I.M. dhe dëshmitarit A.M., për arsyen si më lart, trupi gjykues, bazuar në dispozitën e nenit 335 paragrafi 1, në paragrafi 1.1 dhe 1.3 të KPP-së, ka lexuar deklaratat e të dëmtuarit dhe dëshmitarit të dhëna në Stacionin Policor në Vushtrri.

Në deklaratën e të dëmtuarit I.M. dhënë në Stacionin Policor në Vushtrri me datë 26.10.2000, i njëjti ka theksuar se, me datë 24.10.2000 rreth orës 12:00, ka parë që disa lopë kishin hyrë në arën e tij, të cilat i ka larguar përkohësisht dhe është kthyer në shtëpinë e tij që të vazhdoj punën, pas një orë, kishte shkuar M. me traktor nga njëri drejtim, e nga tjetri babai i tij I. me djalin e tij A., së pari A. ka dalë nga vetura me një shufër të hekurt (80cm), kurse M. kishte dalë nga traktori me pushkë automatike, duke e drejtuar nga i dëmtuari dhe bashkëshortes së tij, i dëmtuari ka theksuar se A. ka tentuar disa herë që ta godasë me shufër, por bashkëshortja e tij ishte në mes, pastaj kishte shkuar I. dhe i ka tërhequr M. dhe A. nga oborri, dhe M. i ishte drejtuar me fjalët se ara është e tij dhe se të njëjtën e kishte blerë në vitin 1972. Tutje ka theksuar se pas 20 minutave M. ka shkuar me traktor dhe ka filluar që ta lëvroj arën, ndërkohë ka shkuar N. dhe pasi që i është afruar M., M. i kishte drejtuar automatikun në gjoks dhe pastaj N. e ka kapur I. dhe e kishte drejtuar në drejtim të M., tutje ka theksuar se M. e ka gjuajtur me automatik disa herë në rafalë të shkurtër, derisa i dëmtuari është shtrirë në tokë, dhe pastaj kishin ardhur bashkëshortja e tij, bashkëshortja e N., si dhe 3 fëmijët, ku bashkëshortja e tij ka shkuar dhe e ka ndarë N. nga I., duke e tërhequr në drejtim të shtëpisë.

Në deklaratën e dëshmitarit A.M., dhënë në Stacionin Policor në Vushtrri me datë 25.10.2000, i njëjti ka deklaruar se, me datën 24.10.2000 rreth orës 09:00 të mëngjesit, vëllau i tij i vogël A.M., i moshës 15 vjeçarë kishte lëshuar bagëtinë për të kullos, pastaj rreth orës 12:00 bagëtinë i ka kishte marrë S. të cilit mbiemrin nuk ia ka ditur, me të kuptuar këtë fakt, fillimisht tek S. kanë shkuar babai i dëshmitari I., si dhe vëllau i tij M., ndërsa pas pak ka shkuar edhe vet dëshmitari tek shtëpia e S., i njëjti ka theksuar se kur kanë shkuar S, veq i kishte lëshuar bagëtinë dhe kishte theksuar se vetëm i kam larguar nga ara ime, mirëpo sipas dëshmitarit ai i ka marrë bagëtinë dhe i ka mbyllë. Tutje ka theksuar se pas kësaj ngjarje ka dalur në qytet dhe kur është kthyer në shtëpi, nëna e tij e ka njoftuar se kishte dëgjuar disa krisma, pasi që M, dhe I, kishin shkuar për ta lëvruar arën, gjithashtu kishte dëgjuar se aty anë shkuar edhe policia dhe i njëjti ishte drejtuar në Stacion Policor, pasi që babai dhe vëllau i tij nuk ishin në shtëpi, përfundimisht ka deklaruar se nuk ka qenë në vendngjarje dhe nuk di se çfarë ka ndodhur me babain dhe vëllaun e tij.

Pas administrimit të provave, i akuzuari M.M. ka deklaruar se mbetet në tërsi pranë deklaratës që ka dhënë në Stacionin Policor në Vushtrri me datë 26.10.2000, dhe se nuk ka tjetër se çfarë të shtoj. Në deklaratën e lartcekur i njëjti ka theksuar se, me datë 24.10.2000, rreth orës 12:00 kanë patur një konflikt rreth kullosjes së bagëtive në një arë të një serbi në Maxhunaj, mirëpo në atë konflikt nuk ka pasur sulme fizike, i pandehuri rreth orës 16:00 ka shkuar për ta lëvruar të njëjtën arë, pastaj ka shkuar N.M. duke i thënë babit të pandehurit I, se kush të ka thënë me hy në këtë arë dhe pastaj e kishte kapur për gjoksi, derisa i pandehuri ishte afruar që ta ndihmoj babain e tij, në atë moment kishte shkuar I. me një pushkë automatikë dhe kishte shtënë 10 herë rafalë të shkurtër në drejtim të pandehurit, tutje ka theksuar se pastaj kishin shkuar gratë e I. dhe N. dhe i kishin ndarë, e gjitha kjo sipas tij kishte zgjatë rreth 15 minuta dhe në fund i njëjti ishte drejtuar ën shtëpinë e tij, kurse për babain e tij nuk e din se ku ka shkuar.

Gjetjet e gjykatës:

Gjykata, pasi ka administruar provat personale, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv.

Për gjykatën, nuk është kontestues fakti se ditën kritike, përkatësisht me datë 24.10.2000 ka pasur një konflikt mes të pandehurit M.M., babait të tij I.M. në njërën anë dhe të dëmtuarit I.M., dëshmitarit N.M. në anën tjetër dhe ky fakt vërtetohet nga deklaratat e të dëmtuarit, të dëshmitarëve, si dhe nga vet deklaratat e të pandehurit, ku secili prej tyre deklaroi se në të njëjtën ditë ka pasur konflikt mes tyre edhe pse duke dhënë arsye të ndryshme nga deklaratat e njëri tjetrit.

Gjithashtu, për gjykatën nuk është kontestuese as fakti se i gjithë konflikti ka ndodhur në një arë në fshatin Maxhunaj, Komuna e Vushtrrisë, derisa i pandehuri dhe babai i tij ishin duke e lëvruar atë arë, e që më pastaj kishin ardhur i dëmtuari I.M. dhe dëshmitari N.M., e më vonë edhe dëshmitaret S. dhe T.M..

Nuk ishte kontestuese po ashtu as fakti se nga kjo ngjarje nuk kishte të lënduar nga asnjëra prej palëve të përfshira në këtë rast në këtë rast dhe kjo përveç se vërtetohet nga faktet se në shkresat e lëndës nuk kishte dokumentacion mjekësor, një fakt i tillë nuk ishte paraqitur as nga vet palët.

Kontestuese në këtë çështje penale, ishte nëse se i pandehuri M.M., ditën kritike, ka shtënë me pushkë automatike në drejtim të dëmtuarit I.M., ashtu siç është e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës.

Trupi gjykues, pas administrimit të gjitha provave personale në shqyrtim kryesor në kuptim të nenit 7 dhe 360 të KPP-së, ka gjetur se nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet si në aktakuzën e ish Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda.

Fillimisht, Gjykata duke analizuar provat personale, përkatësisht deklaratën e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve të dhëna gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, e gjithashtu ato të dhëna në polici, e

duke bërë edhe krahasimin e tyre gjeti se në asnjë rrethanë nuk vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, shto këtu faktin se në shkresat e lëndës nuk gjenden as prova materiale me të cilat edhe do të vërtetohej ky fakt.

Në veprimet e përshkruara në dispozitivin e akuzës për të pandehurin M.M., nuk plotësohen të gjitha elementet e përcaktuara në ligj, përkatësisht nuk është vërtetuar se i pandehuri, ditën kritike, ka ndërmarrë veprimet në drejtim të kryerjes së veprës penale për të cilën akuzohet sipas pikës I të dispozitivit.

Gjykata nuk ka arritur të vërtetoj pretendimet e prokurorisë si në aktakuzë se i pandehuri ditën kritike, përkatësisht me datë 24.10.2000, i armatosur me pushkë ilegale automatike ka zbritë nga traktori në tokë, ka marrë në shënjestër me tytën e automatikut viktimën I.M., me ç'rast ka shtënë dy-tri rafalë në drejtim të viktimës, por që nuk ka arritur ta qëlloj, pasi viktima ishte shtrirë në tokë.

Kryetari i trupi gjykues rithekson faktin se në këtë çështje penale, nuk kishte të propozuar qoftë në aktakuzë, apo në seancën e shqyrtimit kryesor, asnjë provë materiale për administrim, andaj i tërë arsyetimi dhe vlerësimi më tej në këtë aktgjykim, do të bëhet vetëm në drejtim të analizimit të deklaratave të dëshmitarëve të dhëna në shqyrtim kryesor apo në polici nga ana e dëshmitarëve.

I dëmtuar sipas pikës I të dispozitivit të aktakuzës ishte I.M. për të cilin edhe pretendohet se ditën kritike është shtënë me automatik në drejtim të tij nga ana e të pandehurit.

Meqenëse, siç u tha edhe më lart, dëshmia e këtij dëshmitari, në kuptim të nenit 335 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-së, ishte lexuar në shqyrtim gjyqësor nga ana e trupit gjykues, për shkak se i njëjti paraprakisht kishte ndërruar jetë, atëherë vlerësimi i deklaratimit të kësaj deklarate në vazhdim të arsyetimit të këtij Aktgjykimi, do të bëhet duke u bazuar në dy dimensione, e para vështruar nga dimensionin juridiko – procedural në kontekst të kufizimeve që gjykata ka në të bazuarit e aktgjyqimit në një provë apo dëshmi të cilën i pandehuri dhe mbrojtësi nuk kanë pasur mundësi ta kundërshtojnë në ndonjërin prej fazave të procedurës penale dhe e dyta, analizimi dhe vlerësimi i kësaj deklarate nga aspekti përmbajtësorë i saj.

Shikuar nga aspekti proceduralo – penal, gjykata është e kufizuar në mbështetjen e aktgjyqimit, duke u bazuar në një provë apo në një dëshmi, të cilën i pandehuri apo mbrojtësi i tij, nuk kanë pasur mundësi ta kundërshtojnë në ndonjë/cilëndo fazë të procedurës penale. Ky kufizim ligjor është paraparë në dispozitën e nenit 257 paragrafi 1 të KPP-së, e cila përcakton se: “1. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.”. Pra cenimi i kësaj dispozite ligjore, nënkupton cenim të disa primeve procedurale – penale dhe atë parimit të drejtpërdrejtë dhe parimit të kontradiktoritetit, ashtu që cenimi i këtyre dy parimeve, në vete do të shkaktonte edhe cenimin e barazisë së “armëve” në procedurën penale. Pra, pamundësia e mbrojtjes që të kundërshtojnë dëshminë e dëshmitarit përmes pyetjeve apo ballafaqimit, dhe

pamundësia e gjykatës dhe mbrojtjes që në mënyrë të drejtpërdrejtë, në shqyrtim gjyqësor, të dëgjojnë deklarin e dëshmitarit, janë shkaqet kryesore përse ligjdhënësi ka paraparë këtë kufizim ligjor. Andaj në këtë kontekst, duke marrë parasysh se siç u theksua edhe më lartë, dëshmia e këtij dëshmitari, duke qenë se ishte i dëmtuar, është kyçe në drejtim të vërtetimit të elementit kryesor të figurës së veprës penale, gjykata, duke marrë për bazë kufizimet ligjore të lartcekura, nuk mund ta bazoj, përkatësisht nuk mund t'i jap rëndësi vendimtare deklaratës së një dëshmitari i cili në asnjë fazë të procedurës, nuk është kundërshtuar nga ana e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

Ashtu siç u theksua edhe më lartë, deklarata e të dëmtuari-dëshmitarit I.M., megjithatë do të analizohet dhe vlerësohet edhe për nga aspekti përmbajtësor i saj.

Në deklaratën e datës 26.10.2000, i dëmtuari I.M. ndër të tjera kishte deklaruar se në ditën kritike kishte parë disa lopë që kishin hyrë në arën e tij dhe pasi që i kishte larguar të njëjtat ishte kthyer në shtëpi pasi që në atë kohë jetonte në Prishtinë. Pas rreth një ore kishte ardhë M. me traktor nga njëri drejtim, kurse nga drejtimi tjetër kishte ardhur I. me djalin e tij A., ku pas një kohe, sipas deklaratës së të dëmtuarit të njëjtit kishin hyrë në oborrin e shtëpisë së tij, ashtu që i pari nga vutura kishte dalë A. me një shufër të hekurit, ndërsa nga traktori kishte dalë M. me automatik të drejtuar në gjoksin e të dëmtuarit dhe të bashkëshortes së tij tutje ka theksuar se pas 20 minutave M. ka shkuar me traktor dhe ka filluar që ta lëvroj arën, ndërkohë ka shkuar N. dhe pasi që i është afruar M., M.i kishte drejtuar automatikun në gjoks dhe pastaj N. e ka kapur I. dhe e kishte drejtuar në drejtim të M., tutje ka theksuar se M. e ka gjuajtur me automatik disa herë në rafalë të shkurtër, derisa i dëmtuari është shtrirë në tokë, dhe pastaj kishin ardhur bashkëshortja e tij , bashkëshortja e N., si dhe 3 fëmijët, ku bashkëshortja e tij ka shkuar dhe e ka ndarë N. nga I. duke e tërhequr në drejtim të shtëpisë.

Nëse analizohet me kujdes deklarata e të dëmtuarit I.M., i njëjti kishte theksuar se M., pasi që i dëmtuari ishte afruar në një distancë, pa saktësuar se në çfarë distance, kishte gjuajtur me automatik disa herë me rafalë të shkurtër, por siç mund të vërehet nga deklarimi i të dëmtuarit i njëjti nuk kishte arritur të sqaronte fillimisht distancën ndërmjet tij dhe të pandehurit, nuk kishte sqaruar se në çfarë drejtimi e kishte mbajtur i pandehuri automatikun dhe gjithashtu pretendimi i të dëmtuarit se kanë qenë të shtëna në dy-tre rafalë, bie në kundërshtim edhe me deklaratën e dëshmitares S.M., e cila në seancën e shqyrtimit kryesor, në pyetjen e prokurorit të shtetit se a ka qenë vetëm një e shtënë apo disa, e njëjta ishte përgjigjur se ka qenë vetëm një e shtënë (shih për këtë procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 06.02.2025, faqe 14, përgjigja e 5 e dëshmitares). Në këtë kontekst pretendimi i të dëmtuarit-dëshmitarit se ka pasur të shtëna dhe atë dy-tri rafalë, nuk mbështetet me asnjë provë materiale. Siç ka theksuar edhe vet i dëmtuari por edhe dëshmitarët tjerë në këtë rast, pas ngjarjes kanë ardhur policia pasi që paraprakisht dikush i kishte njoftuar, mirëpo në shkresat e lëndës nuk ka raport të vendit të ngjarjes, nuk ka skicë të vendit të ngjarjes, nuk ka ndonjë vërtetim mbi sekuestrimin e ndonjë arme dhe gjithashtu nuk ka asnjë provë tjetër që do të dëshmonte se në vendin e ngjarjes janë gjetur gjurmë të përdorimit të armës automatike, qoftë gëzhoja të predhave apo shenja të tjera të predhave, si dhe në mungesë të vet armës me të cilën pretendohet se është shtënë, andaj në mungesë të këtyre provave gjykata nuk ka mundur të ia falë besimin dëshmisë së këtij dëshmitari lidhur me pretendimet se ditën kritike është shtënë me automatik nga i pandehuri në drejtim të tij.

Siç u theksua më lart, i dëmtuari I.M. ne deklaratën e tij, kishte theksuar se kishte qenë larg nga i pandehuri në një distancë pa e saktësuar se sa, madje as afërsisht se në çfarë distance, andaj lidhur me këtë rrethanë, gjykata ka analizuar deklaratat e dëshmitarëve tjerë të cilët sipas shkresave të lëndës ishin dëshmitarë okular në vendin e ngjarjes. Kështu lidhur me çështjen e distancës ndërmjet të dëmtuarit I. dhe të pandehurit, dëshmitari N.M. në deklaratën e dhënë në polici me datë 26.10.2000 kishte deklaruar se “...në anën e arës ka qenë I.M. në largësi 150 metra përafërsisht...”, të cilin fakt e ka konfirmuar edhe gjatë deklarimit në shqyrtim kryesor kur është ballafaquar nga ana e prokurorit me një pjesë të deklaratës së tij, e ku ishte e përfshirë edhe kjo çështje, ndërsa dëshmitarja S.M., lidhur me çështjen e distancës ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarit I.M. kishte deklaruar se, kishte qenë rreth 25-30metra. Andaj duke qenë se vet i dëmtuari nuk kishte përshkruar distancën ndërmjet tij dhe të pandehurit, ndërsa nga analiza e dëshmimeve të dy dëshmitarëve N.M. dhe S.M., të cilët kanë dhënë vlerësime thellësisht të ndryshme në raport me distancën ndërmjet të dëmtuarit dhe të pandehurit, ku njëri deklaroi se distanca ishte 150metra e tjetri 25-30 metra, në mungesë të provave tjera kjo çështje për gjykatën ka mbetur e pa sqaruar, përkatësisht e pa provuar.

Nga dëshmia e dëshmitarit N.M. (i cili ishte i propozuar si i dëmtuar sipas pikës II të dispozitivit për të cilin prokurori është tërhequr nga ndjekja penale), gjykata nuk ka arritur të vërtetojë asnjë nga elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri M.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor dëshmitari ndër të tjera kishte theksuar se në ditën kritike, në vendin e ngjarjes, përkatësisht në arë, është afruar në vendin ku po punonte M. dhe derisa është afruar, i pandehuri ka marrë automatikun dhe ka gjuajtur në drejtim të tij, ku në këtë moment dëshmitari ka kapur babain e këtu të pandehurit I.M. dhe e ka shfrytëzuar si mburojë, duke i thënë të pandehurit, “na vrajë të dy”. Lidhur me distancën e të pandehurit në momentin kur siç pretendon dëshmitari i njëjti ka shtënë, ka theksuar se kjo distancë ka qenë diku 40-50 metra larg. Dëshmitari në shqyrtim ka theksuar se ka parë të pandehurin të ketë shtënë me armë, fillimisht në drejtim të tij e pastaj edhe në drejtim të I.M.t, në shqyrtim gjyqësor ky dëshmitar ka mohuar që të jetë goditur nga i pandehuri me ndonjë mjet në dorë për shkak se siç ka thënë, nuk e ka pasur afër të pandehurin për asnjë moment, lidhur me atë se ku kanë goditur predhat, dëshmitari ka deklaruar se nuk e di.

Trupi gjykues nuk ia ka falur besimin deklarimit të këtij dëshmitari, për shkak se deklarata e të njëjtit ishte jo konsistente, kundërthënëse si në raport me deklarimin e dëshmitarit në shqyrtim kryesor, e po ashtu edhe në raport me deklarimin e tij të dhënë në polici menjëherë pas ngjarjes. Fillimisht rrëfimi i dëshmitarit për rrjedhjen e ngjarjes në krahasim me atë që i njëjti kishte thënë në polici dhe në shqyrtim gjyqësor dallon esencialisht. Përderisa në polici dëshmitari për asnjë moment nuk kishte deklaruar se i pandehuri kishte shtënë në drejtim të tij, të kundërtën e thotë në shqyrtim kryesor kur deklaroi se “M. e ka marrë automatikun dhe ka gjuajtur në drejtimin tim...” (shih për këtë procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 06.02.2025 faqe 5 përgjigja e 2 e dëshmitarit). Në këtë kontekst sa i përket faktit se në çfarë drejtimi ka shtënë i pandehuri siç pretendon dëshmitari, ka kundërthënënie substanciale në vet deklarimin e dëshmitarit në shqyrtim kryesor, për shkak se në pyetjen e parashtruar nga ana e kryetarit të trupi gjykues se pse në polici nuk ka deklaruar që i pandehuri M. ka shtënë në drejtim të tij, dëshmitari është përgjigjur “*unë nuk e di nëse M. ka shtënë apo jo në drejtimin tim, pasi që asnjë predhë nuk kam dëgjuar të ketë*

kaluar pranë meje, apo para këmbëve të mija, ndoshta ka mundur që i njëjti të shtënë në drejtim të I.M.t, por për këtë nuk jam i sigurt” (shih për këtë procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 06.02.2025 faqe 9 përgjigja e parë e dëshmitarit), pra përderisa dëshmitari fillimisht deklaroi se i pandehuri ka shtënë në drejtim të tij, më vonë gjatë deklarimit të tij, përgjigjet se nuk e di që i pandehuri M. ka shtënë apo jo në drejtim të tij, pasi që nuk ka dëgjuar asnjë predhë të ketë kaluar pranë tij.

Nëse analizojmë deklarin e dëshmitarit lidhur me atë se i pandehuri M. ka shtënë në drejtim të të dëmtuarit I.M., në polici dëshmitari kishte deklaruar se përderisa I.M. ishte në arë në një largësi 150metra nga M. dhe ky i fundit i kishte drejtuar automatikun me të shtëna dy-tri rafalë, në shqyrtim kryesor fillimisht ka deklaruar se të shtënat kanë qenë në drejtim të tij e pastaj në drejtim të I.M.t, më vonë siç u citua më lart, në raport me të dëmtuarin I.M., përkatësisht për të shtënat në drejtim të tij, dëshmitari është përgjigjur se ndoshta i pandehuri ka shtënë në drejtim të I.M. por për këtë nuk është i sigurt.

Dëshmitari nuk ishte konsistent as lidhur me faktin se në çfarë drejtimi i pandehuri ka mbajtur armën në raport me të dëmtuarin I.M.. Përderisa në polici kishte theksuar se i pandehuri M., përderisa i dëmtuari I. ishte në një largësi 150 metra, kishte drejtuar automatikun në drejtim të tij dhe kishte shtënë dy-tri rafalë, në shqyrtim kryesor, në pyetjen e anëtarit të trupi gjykues se në çfarë drejtimi-pozicioni e ka mbajtur armën M., dëshmitari është përgjigjur “armën M. e ka majtë me tytë pak më lart në momentin kur ka shtënë.

Dëshmitari N.M. nuk ishte konsistent as në rrjedhën e ngjarjes në raport me atë si kishte deklaruar se në polici, dhe se si ka rrëfyer ngjarjen në shqyrtim kryesor. Në këtë kontekst, përderisa dëshmitari në polici kishte theksuar se M. nga traktori kishte marrë armën, ia kishte drejtuar në gjoks në lartësi afro 2 metra, ia kishte drejtuar edhe thikën e armës dhe e kishte goditur në dorën e majtë, se i pandehuri kishte tentuar të shkrepë me armë, mirëpo automatiku kishte qenë i frenuar, në shqyrtim kryesor ky dëshmitar, në pyetjen e prokurorit se a ju ka goditë i pandehuri me ndonjë mjet, dëshmitari është përgjigjur “ jo për shkak se nuk e kam pasur afër në asnjë moment”, ndërsa kur është pyetur, përkatësisht ballafaquar nga ana e prokurorit të shtetit lidhur me këto mos përputhje në deklarin, dëshmitari është arsyetuar me kohën e gjatë të kaluar nga rasti. Gjykata lidhur me këto mos përputhje në deklarinet e dëshmitarit, është e vetëdijshme për kohën e gjatë të kaluar nga rasti e deri në gjykimin e çështjes, megjithatë mos përputhja e deklarinëve të dëshmitarit përveç se në detaje të cilat u elaboruan më lart, edhe në vet rrjedhën e ngjarjes, e bëjnë të pabesueshëm deklarinin e këtij dëshmitari, andaj edhe për këto arsye ka vendosur që mos të ia falë besimin deklarinin të dëshmitarit N.M.

Edhe dëshmitari N.M. kishte deklaruar në polici dhe në shqyrtim kryesor se menjëherë pas ngjarjes kishin ardhur edhe policia, pasi që dikush i kishte njoftuar të njëjtit për rastin, por për çudinë e kësaj gjykate, në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë materiale që do të dëshmonin pretendimet si në aktakuzë, pra siç është thënë edhe më lart nuk është gjetur arma, nuk janë gjendur gëzhoja të predhave përkundër që pretendohet që janë shkrepur rafalë nga automatiku, nuk janë gjendur gjurmë të predhave, nuk ka fotografi të vendit të ngjarjes etj.

Në seancën e shqyrtimit kryesor siç u theksua edhe më lartë, nuk është arritur të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit A.M., pasi që i njëjti ka ndërruar jetë, ndërsa në deklaratën që kishte dhënë në polici menjëherë pas ngjarjes, ky dëshmitar kishte theksuar se në momentin kur ka ndodhur ngjarja ashtu siç pretendohet në aktakuzë ai nuk ka qenë prezent, por për ngjarjen i kishte treguar nëna e tij, ndërsa edhe ky dëshmitar ka konfirmuar se kishin pas një mos marrëveshje me një person me emrin S. mbiemrin e të cilit nuk e dinte dhe kjo mos marrëveshje kishte të bënte me kullosjen e bagëtive, pasi që siç kishte deklaruar dëshmitari personi me emrin S. i kishte larguar bagëtitë e tyre dhe i kishte mbyllur të njëjtat.

Gjykata ia ka falur besimin dëshmisë së këtij dëshmitari lidhur me faktin që nuk ishte kontestues për mos marrëveshjen rreth arës dhe kullotjes së bagëtive, mirëpo që nga dëshmia e këtij dëshmitari nuk ka arritur të zbardhë gjendjen faktike, pasi që i njëjti nuk ishte okular në vendngjarje dhe siç kishte deklaruar ky dëshmitar, për ngjarjen e kishte njoftuar nëna e tij.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 06.02.2025, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar edhe I. M., babai i të pandehurit i cili ka konfirmuar që ditën kritike ka qenë në vendin e ngjarjes dhe ngjarja ka ndodhur afër mbrëmjes. Tutje ky dëshmitar ka theksuar se i kujtohet që kanë ardhë N.me I.M., se kanë qenë larg diku 50-60 metra, dhe se siç ka deklaruar dëshmitari, I.M. kishte pasur një kallash në dorë dhe kishte shtënë në drejtim të tyre dhe pas kësaj kishin ardhur dy gra dhe i kishin tërhequr I.dhe N.Ka mohuar që ditën kritike N. apo I. ta kenë kapur për fyti apo për dore për ta larguar atë , ndërsa lidhur me veprimet e M., dëshmitari ka theksuar se nuk ka bërë asgjë përveç që ka lëvruar arën.

Gjykata nuk ia ka falur besimin dëshmisë së këtij dëshmitari, pasi që e njëjta nuk kishte konsistencë në raport me deklarin e tij të mëhershëm. Kështu përderisa në polici dëshmitari kishte theksuar se kishte ardhë N. dhe i kishte thënë se pse po e lëvron arën, ku edhe e kishte kapur për gjoksi dhe në atë moment I. kishte shtënë me automatik në drejtim të tyre, në shqyrtim kryesor ky dëshmitar ka theksuar se I. dhe N. kishin qenë larg 50-60 metra ku kishin shtënë në drejtim të tyre afër traktorit. Pra për gjykatën, përkundër që ka kaluar një kohë e gjatë, ndryshimi i deklaratës në rrjedhën e ngjarjes e bëjnë të pabesueshme deklarin e tij, siç është e pabesueshme pjesa e deklarin e tij se është shtënë në drejtim të tyre nga ana e këtu të dëmtuarit I.M. për shkak se një fakt i tillë nuk mund të provohet me asnjë provë materiale , përkundër që siç është thënë edhe më lart, në vendin e ngjarjes kishin dalur policia, por në shkresa të lëndës nuk ka asnjë provë materiale që do të dëshmonin pretendimet e këtij dëshmitari se është shtënë me armë nga i dëmtuari I.M.

Në cilësi të dëshmitarit, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 06.02.2025 është dëgjuar S.M. e cila është bashkëshortja e të dëmtuarit tani të ndjerë I.M.. Në këtë seancë dëshmitarja ka theksuar se ditën kritike fëmijët e familjes së tyre dhe familjes M. kishin dalur të luanin mirëpo të njëjtit ishin kacafytur-rrahur mes vete. Në atë moment N. dhe I. kishin dalur për të shikuar se çfarë po ndodhte ku në ndërkohë kishte ardhë i akuzuari me automat dhe kishte filluar që të gjuante, e pas kësaj dëshmitarja kishte ndërhyrë ndërmjet M. dhe I. e N. dhe e tërë ngjarja ishte zhvilluar në arën që ishte pranë shtëpisë së tyre, ndërsa tri ditë pas ngjarjes palët ishin pajtuar. Më tej dëshmitarja kishte theksuar se sa i kujtohet në vend të ngjarjes nga familja M. kishte qenë vetëm i pandehuri. Ka shtuar se e ka parë të pandehurin që ka gjuajtur në drejtim të I., mirëpo që nuk kishte arritur ta qëlloj, pasi I. ishte shtrirë në tokë dhe distanca ndërmjet të pandehurit dhe

të dëmtuarit I. kishte qenë rreth 25-30metra. Lidhur me veprimet e N. atë ditë, dëshmitarja ka theksuar se i njëjti ka ndërhyrë vetëm për ti ndarë fëmijët, sa i përket të shtënave dëshmitarja është përgjigjur se ka qenë vetëm një e shtënë.

Gjykata, deklarimit të dëshmitares se i pandehuri M. ka shtënë në drejtim të dëmtuarit I. në ditën kritike nuk ia fali besimin për disa arsye. Fillimisht në deklarimin e dëshmitares e njëjta thekson se pasi ka ardhë i akuzuari me siç shprehet ajo automat, ka fillu me gjujtë me ç`rast e njëjta ka ndërhyrë ndërmjet M. në njëren anë dhe I. e N. në anën tjetër, ndërsa ka theksuar se i pandehuri ka gjuajtur në drejtim të I. nga një distancë prej rreth 25-30metra. Për gjykatën deklarimi i tillë i rrjedhës së ngjarjes nga ana e dëshmitares është i pabesueshëm dhe i pa mbështeshëm në prova tjera personale dhe gjithashtu edhe kontradiktore me vetveten. Përderisa dëshmitarja deklaroi se distanca në momentin kur siç pretendon ka shtënë i pandehuri në drejtim të I. ka qenë afërsisht 25-30 metra, në të njëjtën kohë e njëjta deklaroi se personalisht ka hyrë dhe ka ndarë të pandehurin nga I. dhe N.. Pra nëse distanca në momentin e gjuajtjes me armë siç pretendon dëshmitarja ka qenë 25-30 metra, si ka mundur e njëjta të ndërhyjë mes palëve për t'i ndarë kur ata, siç thotë vet dëshmitarja, kanë qenë larg njëri tjetrit.

Në anën tjetër sa i përket distancës ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarit I., kjo bie në kundërshtim edhe me deklaratën e dëshmitarit N.M. i cili në polici, menjëherë pas ngjarjes kishte theksuar se I. ishte në një distancë afërsisht 150 metra larg. Deklarimi i dëshmitares për rrjedhën e ngjarjes duke nisur nga motivet si dhe zhvillimin e rastit kritik është në kundërshtim me provat tjera personale, konkretisht me deklaratën e dëshmitarit N.M. e ku për këtë të fundit dëshmitarja në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se të vetmin veprim që e ka bërë N. atë ditë ka qenë që ka hyrë ndërmjet fëmijëve me qëllim për ti ndarë.

Lidhur me besueshmërinë e deklaratës së dëshmitares S.M., gjykata e rikujton faktin se kjo dëshmitare asnjëherë më parë nuk ishte deklaruar për këtë rast dhe deklarimi i saj para gjykatës për këtë çështje penale ishte hera e parë. Andaj në mungesë të një deklarimi të mëhershëm me qëllim krahasimin e deklaratave të dëshmitarëve, ky fakt e zbehë edhe më tej besueshmërinë e deklarimit të dëshmitarit të dhënë në shqyrtim kryesor, andaj edhe vendosi që të mos ia falë besimin edhe për arsye të cilat disa herë u theksuan më lart e që kanë të bëjnë me mungesën e provave materiale që do ta mbështesnin deklarimin e dëshmitares por edhe tezën e akuzës në përgjithësi.

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor është dëgjuar edhe dëshmitarja T.M., e cila ka deklaruar se ditën kritike derisa sa ka qenë duke përgatitë darkën, në ato momente i ka dëgjuar fëmijët duke qarë, pastaj ka dalë për të shikuar se çfarë ka ndodhur dhe aty në rrugë afër shtëpisë i kishte parë N., fëmijët, si dhe S.M., pastaj i kishte marrë fëmijët për ti futur brenda. Tutje e njëjta ka theksuar se vetëm ka dëgjuar që ka ndodhur një zënkë e vogël, mirëpo se nuk e di as çfarë zënke ka qenë, as nuk i kujtohet se a ka dëgjuar ndonjë krismë atë ditë, vetëm e dinë se janë mbledhur burrat dhe kushërinjtë që ta zgjidhin atë çështje. Nga deklarimi i këtij dëshmitari nuk ka arritur të vërtetoj asgjë lidhur me gjendjen faktike për shkak se gjatë tërë kohës të deklarimit të saj dëshmitarja ka theksuar se e tëra çfarë dinë ajo për këtë ngjarje është një zënkë mes fëmijëve në rrugën afër shtëpisë, por edhe për një zënkë që kishte ndodhur me disa fqinj të tyre, por nuk dinte madje as kush ishin personat që familjarët e dëshmitares kishin pasur atë zënkë. Gjykata, sikurse edhe në rastin e dëshmitares S.M., rikujton faktin se edhe dëshmitarja T.M. nuk kishte dhënë deklaratë në fazën e hetimeve në këtë çështje penale, prandaj edhe për gjykatën është e vështirë

vlerësimi në aspekt të besueshmërisë së deklaratës në mungesë të një deklaratë të mëparshme që do të shërbente për krahasim dhe vlerësim real e objektiv.

I pandehuri M.M. në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 06.02.2025, ka deklaruar se nuk ka tjetër se çfarë të shtoj, përveç asaj që ka deklaruar në polici me datë 26.10.2000. Në këtë deklaratë, i njëjti ka theksuar se, me datë 24.10.2000, rreth orës 12:00 kanë patur një konflikt rreth kullosjes së bagëtimeve në një arë të një serbi në Maxhunaj, mirëpo në atë konflikt nuk ka pasur sulme fizike, i pandehuri rreth orës 16:00 ka shkuar për ta lëvruar të njëjtën arë, pastaj ka shkuar N.M. duke i thënë babait të pandehurit I. se kush të ka thënë me hy në këtë arë dhe pastaj e kishte kapur për gjoksi, derisa i pandehuri ishte afruar që ta ndihmoj babain e tij, në atë moment kishte shkuar I. me një pushkë automatike dhe kishte shtënë 10 herë rafalë të shkurtër në drejtim të pandehurit, tutje ka theksuar se pastaj kishin shkuar gratë e I. dhe N. dhe i kishin ndarë, e gjitha kjo sipas tij kishte zgjatë rreth 15 minuta dhe në fund i njëjti ishte drejtuar në shtëpinë e tij, kurse për babain e tij nuk e din se ku ka shkuar.

Një mbrojtje e tillë e dhënë nga i pandehuri në fazat e mëhershme të procedurës për gjykatën është plotësisht e pabesueshme, për faktin se pretendimet e të njëjtit lidhur me rrjedhën e ngjarjes në kontekst të asaj se siç është deklaruar i pandehuri, kishte ardhë i dëmtuari sipas kësaj lënde I.M. dhe kishte shtënë 10 herë në rafalë të shkurtra nuk gjen mbështetje në prova materiale, e as ato personale. Është përmendur në disa raste në këtë arsyetim të këtij aktgjykimi, fakti se pothuajse menjëherë pas ngjarjes në vendin e ngjarjes kishin ardhur edhe policia, mirëpo nuk ishte arritur të gjendej armë e as prova tjera materiale siç janë gëzhojat apo gjurmë tjera të predhave, duke qenë se pretendohet se ka pas të shtëna rafalë nga të dyja palët, por ky fakt nuk është arritur të vërtetohet me provat e propozuara në aktakuzë e të administruara në shqyrtim kryesor. Në fakt e vetmja gjë që ka mundur të vërtetohet nga deklarimi i të pandehurit në fazat e mëhershme të hetimeve, e që gjykata ka mundur ta provoj në shqyrtim kryesor, ka qenë fakti jo kontestues ndërmjet palëve se ditën kritike kishin pasur një mosmarrëveshje me të dëmtuarin I.M. dhe dëshmitarin N.M. dhe atë lidhur me kullotjen e bagëtimeve, ndërsa që pretendimet e mbrojtjes për versionin e ngjarjes më tutje, nuk janë provuar në shqyrtim kryesor, prandaj edhe kanë mbetur vetëm në stadin e pretendimeve.

Gjykata rikujton se vepra penale e vrasjes në tentativë mund të kryhet vetëm me dashje, qoftë me dashje direkte apo atë eventuale, ndërsa që sipas përkufizimeve ligjore dhe doktrinës juridike, tentativa është institut juridiko penal që nënkupton ndërmarrjen aktive të veprimeve të caktuara në drejtim të realizimit të figurës së veprës penale, por që nuk arrinë të shkakton pasojën e dëshiruar.

Në kontekst të interpretimit të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, në raport me gjendjen faktike të përshkruar, analizuar dhe vërtetuar në shqyrtim gjyqësor, gjykata nuk ka arritur të vërtetoj se në veprimet e të pandehurit janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën i njëjti akuzohet. Për më tepër, për gjykatën ka mbetur e pavërtetuar dhe vetëm në stadin e indicieve apo dyshimeve por assesi jo të dyshimit të bazuar mirë fakti nëse i pandehuri kishte shtënë me ndonjë apo çfarëdo arme marrë parasysht faktin se, siç pretendohet nga palët se ka pasur të shtëna rafalë me armë automatike në njërën anë dhe në anën tjetër se në vendin e ngjarjes kishin shkuar policia e i cili fakt është pohuar nga shumica e dëshmitarëve në deklaratimet e tyre,

andaj mungesa e provave materiale siç janë raporti nga vendi i ngjarjes, skica e vendit të ngjarjes, fotografitë apo çfarëdo prove tjetër që do të dëshmonte se në vendin e ngjarjes është apo janë përdorur armë, për këtë gjykatë mbetet i paprovuar edhe vet fakti i posedimit apo përdorimit të armës në ditën kritike nga cilado palë, duke qenë se si nga pala e dëmtuar, ashtu edhe nga i pandehuri pretendohet se janë shtënë rafalë nga arma automatike, andaj nga të cekurat më lart, në mungesë të provave që do të vërtetonin përtej dyshimit të bazuar mirë gjendjen faktike si në dispozitiv të aktakuzës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi duke marrë vendim lirues për të pandehurin.

Mbi bazën e këtyre rrethanave faktike, Gjykata ka ardhur në përfundim se nuk mund të vërtetohet pretendimi si në dispozitiv të aktakuzës se i pandehuri, në ditën kritike, ka tentuar ta privoj nga jeta, të dëmtuarin I.M., element ky kyç i figurës së veprës penale nga neni 30 al.1 të LPK-së. Andaj nga rrethanat e rastit konkret si dhe provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, gjykata vlerëson se prokuroria nuk ka arritur të argumentojë faktin se i pandehuri të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Pra nuk është arritur të provohet se i pandehuri ka ndërmarrë veprimet me të cilat do të formohej figura e veprës penale për të cilën i njëjti akuzohet.

Gjykata rikujton një ndër parimet kryesore të procedurës penale, "In dubio pro reo", i përcaktuar në nenin 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij"*. Andaj në këtë rast Gjykata të gjitha faktet që kanë pasur mëdyshje, konkretisht që nuk janë vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, i ka interpretuar në favorin e të akuzuarit, duke marrë aktgjykim lirues për të njëjtin në bazë të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

-Vendimi lidhur me pikën II të dispozitivit-

Gjykata, pasi që Prokurori i Shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, është tërhequr nga aktakuza dhe ndjekja penale ndaj të pandehurit M.M., për shkak të veprës penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armës nga neni 328 par.1 të KPPK-së, vlerëson se është në kompetencën e prokurorisë që në çdo kohë të tërhiqet nga ndjekja penale, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Kjo duke u bazuar në dispozitën e nenit 51 të KPP-së, e cila dispozitë përcakton se: *"Prokurori i shtetit mund të tërhiqet nga ndjekja deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor para gjykatës themelore, kurse në procedurat para gjykatës më të lartë, ai mund të tërhiqet nga ndjekja vetëm në rastet e parapara me këtë Kod."*

Bazuar në këto arsye, gjykata vlerëson se pas tërheqjes së prokurorit nga ndjekja penale për pikën dy (II) të aktakuzës, çështja ka mbetur e pa objekt dhe se nuk mund të vazhdoj shqyrtimin gjyqësor.

Mbi këtë bazë, trupi gjykues ka konstatuar se në tërësi janë plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e akuzës dhe nxjerrjen e aktgjykimit refuzues në mbështetje të nenit 362 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, duke qenë se i akuzuari është liruar nga akuza.

Sa i përket kërkesës pasurore-juridike, Gjykata nuk ka vendosur sepse, i dëmtuari sipas pikës I të dispozitivit të aktakuzës I.M., ka ndërruar jetë.

Andaj Gjykata, duke u bazuar me neni, 7, 359, 360,362, 363, 449, dhe 453 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.88/2007, datë 28.02.2025

Zyrtarja ligjore
Doruntina BEKA

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.

Numri i lëndës: 2019:141556
Datë: 28.02.2025
Numri i dokumentit: 06919926